


Vështirësitë e qasjes në dokumente publike



Dokumentet publike edhe pse do të duhej të ishin të qasshme për qytetarët, mediat apo shoqërinë civile sipas ligjit në Kosovë, shpesh mbahen brenda sirtarëve të institucioneve.

Institucionet publike edhe pse kanë obligim të publikojnë online dokumentet që janë me rëndësi për publikun, rrallë herë e bëjnë këtë. Përveç që nuk i publikojnë, institucionet shumë shpesh nuk lejojnë qasje në dokumente edhe pas kërkesave zyrtare për qasje. Zakonisht në këto raste, institucionet nuk përgjigjen fare, japin përgjigje gjysmake apo refuzojnë komplet përgjigjet.

Heshtja e institucioneve


Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në vitin 2017 kishte kërkuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) qasje në raportet financiare të subjekteve politike të vitit 2015, raporte të cilat nuk ishin të audituara. Pas kalimit të afatit ligjor për përgjigje në kërkesë, kjo organizatë kishte kontaktuar me zyrtarët e KQZ-së për verifikim të pranimit të kërkesës.

Përgjigja e institucionit kishte qenë se nuk kanë pranuar asnjë email për këtë çështje. Pas kësaj **KDI kishte ridërguar edhe njëherë kërkesën por edhe pas kalimit të afatit të dytë kohor për përgjigje, KQZ nuk kishte kthyer përgjigje.**

Për këtë KDI kishte drejtuar kërkesë te Avokati i Popullit, i cili në vitin 2018 i jep të drejtë KDI-së për qasje në të gjitha raportet financiare të subjekteve politike. Tutje pas përgjigjes nga AP, KQZ i kthen përgjigje KDI-së se raportet nuk mund t'i marrin meqë ligji për financim të subjekteve politike nuk e lejon një gjë të tillë. KQZ në këtë rast kishte vepruar në kundërshtim me vendimin e AP.

Kërkesë të ngjashme në të njëjtin institucion kjo organizatë ka parashtruar përsëri këtë vit por nuk ka marrë përgjigje.

Ky është vetëm një nga rastet që institucionet publike nuk i kanë përgjigjur fare organizatave të shoqërisë civile. Shumë prej përfaqësuesve të organizatave thonë se këto janë rastet më të shpeshta të refuzimeve, ku sipas tyre kjo është metoda më e papërshtatshme meqenëse nuk ka fare bashkëpunim në mes të palëve.



“

KDI kishte ridërguar edhe njëherë kërkesën por edhe pas kalimit të afatit të dytë kohor për përgjigje, KQZ nuk kishte kthyer përgjigje.



Qasje e kufizuar në dokumente

Ka raste kur qasja në dokumente nuk lejohet në tërësi ose lejohet shumë e kufizuar.

Në vitin 2014 disa organizata të shoqërisë civile dhe gazetarë kishin kërkuar të kenë qasje në kontratën për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Hani i Elezit.


Qeveria e Kosovës në atë kohë insistonte që qasja nuk mund të lejohet për arsye të mbrojtjes së sekretit afarist dhe që kjo kontratë ishte kontratë ndërkombëtare dhe për këtë qeveria nuk mund ta publikoj atë.

Pas presionit publik, Ministria e Infrastrukturës pati marrë vendim që të lejoj qasjen në këtë dokument, mirëpo **hapja e kësaj kontrate për publikun pati qenë sa për sy e faqe. Kjo ministri kishte vënë në dispozicion vetëm tri kopje të kontratës, një material rreth 200 faqe, duke i pamundësuar kështu të interesuarve konsultimin e saj për një kohë më të gjatë dhe analizë më të thellë pasi që kontrata ishte e hapur për publikun vetëm nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 3 pasdite, një kohë shumë e shkurtë për ta analizuar gjithë materien e saj. Gjithashtu kjo kontratë ishte vetëm në gjuhën angleze.**



“

Kontrata me rreth 200 faqe ishte hapur vetëm për disa ora gjatë ditës dhe duke mos lejuar që të kopjohet asnjë pjesë e saj



Refuzime pa bazë ligjore

Në vitin 2014 Organizata Çohu pati kërkuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) qasje në listën e Organizatave Joqeveritare të cilave kjo ministri ju ka dhënë donacion.

Përgjigjen refuzuese kjo ministri nuk e ka arsyetuar në asnjë dispozitë ligjore (përveç citimit të ligjit në tërësi), duke deklaruar që:

“Duke u bazuar në raportimet e mëhershme të OJQ-së ku ju punoni, e cila materialet zyrtare i trajton me qasje propagandistike dhe qëllime komerciale, gjë që është e ndaluar me po këtë ligj, kërkesa juaj është refuzuar”.

Pas kësaj përgjigje të pabazuar, Çohu ka bërë ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (AP) lidhur me mohimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.


Pas ankesës, AP ka përpiluar një raport të detajuar ku ndër të tjera ka theksuar se:

Me 20 gusht 2014, përfaqësuesja e AP-së, takoi zëdhënësin e MBPZHR-se, me të cilin diskutoi arsyen e refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike të organizatës “Çohu”. Nga ai u kuptua se njëra nga arsyet e ministrisë, **për refuzimin e kërkesës** së organizatës në fjalë, ishte rezultat i mundësisë, se te dhënat e kërkuara, organizata “Çohu”, **mund t’i përdor për publikim në “Preportr”** (Preportr është Qendër e Gazetarisë Hulumtuese e cila funksionon në kuadër të Organizatës Çohu!).

Gjithashtu ky institucion thekson edhe mosgatishmërinë e ministrisë për bashkëpunim ku Avokati i Popullit ka drejtuar dy letra drejt ministrit të MBPZHR-së me qëllim që të informohet për arsyet ligjore të refuzimit të kërkesës. Në të dy rastet AP nuk ka pranuar përgjigje.

“Për më tepër, mosgatishmëria e ministrisë në fjalë, vërehet në moszbatueshmërinë Ligjit Nr. 03/L-215, për Qasje ne Dokumente Publike (LQDP), si dhe ne mosbashkëpunim me AP-në, si parashihet me kompetencat ligjore të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin nr. 03/L-195, për Avokatin e Popullit”.

Raporti në fund rekomandon MBPZHR-në që të rishqyrton kërkesën e organizatës Çohu dhe të **mundësohet qasja në dokumentet e kërkuara**. Megjithatë kjo ministri asnjëherë nuk ka dërguar dokumentet e kërkuara



“

Duke e analizuar çështjen në fjale AP, vëren se kufizimi i pretenduar nga MBPZHR, se materialet mund të shfrytëzohen për “qasje propagandistike”, nuk është përfshirë në ligjin e lartpërmendur për LQDP, te miratuar nga kuvendi, dhe si i tillë kufizimi është kundër kushtetues”, thuhet në raport të AP.



Mbrojtja e “të dhënave personale” mbi interesin publik

Në shumë raste institucionet thirren në mbrojtje të të dhënave personale duke cenuar kështu të drejtën për informacion.

Lëvizja Fol në vitin 2018 dhe 2019 ka kërkuar qasje në të dhënat për shpronësimin e pronave private përgjatë ndërtimit të autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë. Për dy herë radhazi Ministria e Financave pati refuzuar qasjen me arsyetimin se:

Nëse Ministria e Financave do ti bëjë publike këto të dhëna për qytetarët, atëherë do të jetë në kundërshtim të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike, Neni 12, Përjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente 1.2. sigurisë publike, 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat.”

Lidhur me këtë rast Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka dhënë një opinion që mbështetë kërkesën e Lëvizjes FOL, ku ndër të tjera thotë:

“Agjencia konsideron se kufizimi i të drejtës për mbrojtjen e të dhënave është i lidhur me faktin se shpronësimi bëhet nga fondet publike të shtetit dhe për interes publik, e drejta e tyre është e kufizuar dhe ky kufizim është në proporcion me interesin publik”.



Për të njëjtin rast kjo organizatë ka bërë ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe ky i fundit ka rekomanduar që Ministria e Financave të ofrojë qasje në të dhënat e kërkuara.

Në një rast tjetër Organizata Çohu në vitin 2017 kishte kërkuar nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës të dhënat për pagesat bazë dhe shtesë të profesorëve në UP.

Rektorati fillimisht kishte refuzuar qasjen duke u thirrur **në mbrojtjen e të dhënave personale të profesorëve**. Lidhur me këtë Çohu ka bërë ankesë dhe ka kërkuar interpretim nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përgjigjen e saj Agjencia ka theksuar se meqë Universiteti i Prishtinës është një institucion publik dhe paraqet interes për publikun, atëherë duhet të gjendet një ekuilibër në mes të mbrojtjes së të dhënave personale dhe interesit publik:

“Është e mjaftueshme që kërkuarit t`i jepen të dhënat e numrit të profesorëve, emrat, gradat, dhe shuma e mjeteve që ata kanë marrë nga Buxheti Publik, duke u anonimizuar të dhënat personale, të cilat konsiderohen të dhëna të ndjeshme”.

Edhe pas këtij interpretimi, Rektorati nuk është përgjigjur pozitivisht.



Pagesa për qasje në dokumente publike

Në vitin 2016 Instituti GAP ka kërkuar disa të dhëna nga Agjencioni i Regjistrimit të Biznesit (ARBK), mirëpo kjo agjenci ka lejuar qasje me kushtin që për çdo faqe të dokumentit kërkuesi duhet të **paguajë 0.30 euro**. Kjo është arsyetuar duke u thirrur në një nen të Ligjit për Qasje i cili e parasheh këtë.

Mirëpo shumica e kërkuar nga kjo agjenci është në kundërshtim me ligjin, meqë ligji thotë që:

“Një tarifë mund t’i ngarkohet kërkuesit për kopje të dokumentit, e cila është e arsyeshme dhe nuk mund të tejkalojë shpenzimet e vërteta të riprodhimit dhe furnizimit të dokumentit”

Pas kësaj Instituti GAP pas shumë shpjegimeve është dashur që të nënshkruaj një memorandum bashkëpunimi me ARBK që t’i lejohej qasja, pavarësisht që ligji nuk e parasheh nevojën për këtë.

Po kjo agjenci në disa kërkesa të Organizatës Çohu në vitin 2011 pati kërkuar pagesë për çdo faqe të dokumenteve, por pas insistimit që kjo është në kundërshtim me ligjin, ARBK ka vendosur që të lejojë qasje pa pagesë.



Instituti GAP ka kërkuar disa të dhëna nga Agjencioni i Regjistrimit të Biznesit (ARBK), mirëpo kjo agjenci ka lejuar qasje me kushtin që për çdo faqe të dokumentit kërkuesi duhet të paguajë

1 Faqe

**0.30
euro**